

HIDROZIM-T

*Aditiv për betonim gjatë temperaturave të ulëta.
Përgjigjet në: EN 934-2T 6*

Fusha e aplikimit

Betonim në kushte të temperaturave të ulëta (Nën 5°C). Me aplikimin e HIDROZIM-T, si dhe të rekomandimeve për betonim dimëror, është i mundur instalimi i rregullt i betonit në temperatura edhe deri në -20°C.

Cilësi

- Mundëson zhvillim të rregullt të procesit të hidratimit gjatë temperatura të ulëta;
- Mundëson që të fitohen karakteristika të fortësisë së hershme të betonit:
- E reduktin kohën e lidhjes:
- E vazhdon sezonin ndërtimor gjatë tërë vitit:

Karakteristika teknike

Lloji:	Bashkime nitrati
Dukje:	Lëng ngjyrë e çelë kafeje
Materie e thatë:	45,0 ± 2,25 %
Dendësia:	1,32 ± 0,03 g/cm ³
Përmbajtje e klorideve:	<0,1%
Përmbajtje e alkaleve:	<2% pH - faktor: 7,5 ± 1,0

Mënyra të përdorimit dhe dozimi

Dozimi i rekomanduar i Hidrozim-T lëviz në kufijtë prej 0,5 deri 2,0 % në raport e masës së çimentos në përzierjen e betonit. Dozimi varet nga temperatura ambientale gjatë betonimit, temperaturat e pritura në periudhën prej 24 orëve pas betonimit, llojit të prerjes që betonohet dhe ekspozimi i tij në ndikesa atmosferike.

Gjatë temperaturës deri -10° C rekomandohet dozim i Hidrozim-T prej 0,5 deri 1,0 %, ndërsa gjatë temperaturave më të ulëta se -10° C (deri -20° C) rekomandohet dozimi prej 1,0 -2,0 % në raport me masën e çimentos në përzierjen e betonit.

Temperatura e përzierjes së posa bërë të çimentos gjatë vendosjes duhet të jetë së paku +5° C (te prerjet e holla +10° C). Gjatë temperaturave të ulëta ajo mund të arrihet me ngrohje të një pjese ose të të gjitha komponentëve të përzierjes së betonit (uji, çimentoja, agregati). Pas shtimit të Hidrozim-T nevojitet që përzierja e betonit të përziehet më së paku 4-5 minuta dhe betoni i përgatitur në këtë mënyrë duhet të aplikohet sa është e mundur më shpejtë.

Rrezik për jetën: Hidrozim-T nuk përmban materie toksike, por edhe përkundër kësaj nevojitet që të kemi kujdes të mos vijë në kontakt me lëkurën sytë ose të mos gëlltimit. Në rast të spërkatjes në lëkurë ose në sytë nevojitet të lahet me ujë të pastër rrjedhës. Nëse gëlltimit nevojitet që menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore

Zjarr: Hidrozim-T është lëng që nuk mund të ndizet.

Pastrimi dhe depozitimi: Pastrimi i mbetjeve të Hidrozim-T bëhet me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullatave lokale për atë lloj të mbetjeve.

Sipërfaqja e betonit të vendosur duhet të mbrohet nga ngrirja sipërfaqësore. Koha për lirim nga veshja duhet të shtyhet varësisht nga temperatura, përkatësisht nga fortësia e fituar e betonit. Në rast të betonimit me Hidrozim-T në temperatura më të ulëta se -10° C, nevojitet që të ndërmerren masa të posaçme të mbrojtjes për elementet e betonit (ngrohje, përdorim i materialeve izoluese). Për të fituar betone të cilësisë së lartë gjatë temperaturave të ulëta, me arritje të fortësisë të larta të hershme pas lirit të shpejtë nga veshja, rekomandohet përdorimi i Hidrozim-T në kombinim me super-plastifikues. Në kuadër të vëllimit të rekomanduar të dozimit (prej 0,5 deri 2,0 % në raport me masën e çimentos), Hidrozim-T nuk ka ndikësë të rëndësishme në cilësitë e betonit në gjendje të butë ose të formësuar. Për këto shkaqe, gjatë përdorimit të Hidrozim-T nevojitet që të bëhet ndryshim në përbërjen e betonit që përdoret në kushte të temperaturës normale, dhe për të cilin me analiza paraprake është dëshmuar cilësia e kërkuar.

Efekti i tej-dozimit

Nëse Hidrozim-T tej-dozohet mund të ndodh humbje e konsistencës që betonit të freskët, si dhe përshpejtim i procesit të lidhjes së betonit.

Kompatibiliteti

Hidrozim-T është kompatibel me më shumë aditivë nga programi i ADING, nga grupi i plastifikuesve, super-plastifikuesve, aerantë, aditivëve për mos-depërtueshmëri ndaj ujit të betonit e tj. Rekomandohet që gjatë betonimit dimëror Hidrozim-T të përdoret në kombinim me plastifikues dhe super-plastifikues. Aditivët e ndryshëm dozohen veç-e-veç, përkatësisht përziehen mes vete para vënies së tyre në përzierjen e betonit. Hidrozim-T është i përdorshëm në të gjitha llojet e portland çimentos, përfshirë edhe çimentot rezistente ndaj sulfateve.

Paketimi

Shishe plastike: 1,3kg
Govata plastike: 7dhe28 kg.
Fuçi: 280 kg.
Kontejnerë plastik: 1300 kg.

Vendosja në depo

Në ambalazh origjinal në temperaturë prej -20° C deri 35° C dhe i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell. Afati i përdorimit 12 muaj.